

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR TRAJTIMIN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME” NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj, i propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të sistemit arsimor dhe atij shëndetësor, si dhe punësimit të studentëve të mjekësisë pas përfundimit të studimeve, duke i dhënë përparësi punësimit të tyre në sektorin e mjekësisë në vend, duke krijuar efekte afatgjata në përmirësimin e cilësisë së shërbimit shëndetësor në vend.

Projektligji ka objektiv përcaktimin e mënyrës së trajtimit të veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, kur plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj, si dhe sigurimi i burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 57 të Kushtetutës përcaktohet e drejta për arsim, si një e drejtë universale, kushtetuese, që i takon çdo qytetari në çdo shoqëri, e cila garantohet edhe përmes këtij projektligji, pasi përmbajtja e tij nuk cenon thelbin e kësaj të drejte kushtetuese, duke qenë se çdo subjekt i zbatimit të saj ka të drejtën e zgjedhjes nëse dëshiron të përfitojë nga lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë apo nëse nuk pranon për të lidhur këtë marrëveshje, duke iu përgjigjur detyrimeve që lindin për pagesën e tarifave të studimit deri në nivelin e kostos së përlogaritur për ndjekjen e këtyre studimeve.

Interesi publik për të garantuar plotësimin e nevojave për burime njerëzore në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë është mjaft i lartë, prandaj edhe dispozitat që përcillen përmes këtij projektligji janë hartuar në përputhje me nevojat e diktuar në vend për përmbushjen e këtij interesi të lartë publik.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.68/2021, “Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave”, i cili, synon ndër të tjera, përmirësimin e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe një strategji të re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Si çdo krizë, edhe pandemia botërore e COVID-19 i solli botës një tragjedi të re, por, në të njëjtën kohë, edhe një mundësi për të parë të ardhmen në një dritë tjetër. Shumë studime të publikuara sot mbi shkaqet, pasojat dhe efektivitetin e politikave të ndjekura nga vende të ndryshme në përgjigje të pandemisë sugjerojnë së pari nevojën për një koordinim më të mirë të politikave sektoriale nacionale me një qasje të orientuar nga shëndeti dhe, së dyti, një koordinim më të mirë për një përgjigje të unifikuar globale ndaj sfidave që dalin përtej kufijve nacionalë. Pandemia gjeneroi efekte negative sa në aspektin shëndetësor, aq edhe në atë ekonomik e financiar, në edukim, transport, turizëm, mjedis, kohezionin social etj. Ndaj, politikat për rimëkëmbjen pas pandemisë do të duhet të rimodelohen për të adresuar në të njëjtën kohë efektet dhe për të prodhuar impakt në shumë sektorë.

Ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, e miratuar me vendimin nr.88, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, konkretisht, me qëllimet e politikës në fushën e arsimit, në fushën e shëndetësisë dhe në atë të punësimit, përkatësisht, si më poshtë:

“3. Arsimi i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik dhe transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit;

“2. Progresi drejt mbulimit universal shëndetësor nëpërmjet sigurimit të përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të popullatës”;

“2. Mundësimi i punësimit të denjë nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në tregun e punës.”.

Ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr.621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026). Vizioni i MAS-it për sektorin e arsimit synon ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë, studentëve etj., duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Përmes këtij projektligji synohet përmbushja e objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, si më poshtë:

Objektivi specifik C.3 : Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës;
Objektivi specifik C.5: Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.

Arsimi i lartë synon që t’u sigurojë të diplomuarve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi. Sistemet e arsimit të lartë përpiqen të prodhojnë të diplomuar me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike, profesionale dhe të disiplinës specifike, veçanërisht në fushën e mjekësisë, e cila përbën fushën më të rëndësishme të jetës dhe shëndetit të qytetarit.

Ky projektligj përmbush edhe synimet dhe objektivat e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, të miratuar me vendimin nr.210, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030”.

Me qëllim ruajtjen e burimeve njerëzore, profesionistëve shëndetësorë në vend, por dhe rritjen e interesit të tyre për të punuar në sektorin shëndetësor publik, si pjesë e rritjes së investimeve në shëndetësi, propozohet miratimi i këtij projektligji i cili synon mbështetjen financiare të kandidatëve/studentëve që regjistrohen apo ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, me qëllim krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për 2023, miratuar me vendimin nr.862, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të

përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj ka ardhur edhe si nevojë e përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të arritjeve akademike të studentëve, përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë, si dhe një mbështetje për të rritur dhe përmirësuar statusin ekonomik të studentëve. Gjithashtu, edhe si një mbështetje në veprimtarinë akademike të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjatë kohës së pandemisë COVID-19, e cila krijoi një situatë të paprecedentë me impakt serioz në nivel global në jetën e individëve, duke sjellë nevojën e përballjes me sfida të reja, sektori i shëndetësisë u vendos në një sprovë të madhe për të përballuar këtë situatë.

Në kuadrin e nevojave për shkak të pandemisë COVID-19, u vunë në dispozicion 25 milionë euro për të forcuar sistemin shëndetësor, gjë që mundësoi garantimin e mbrojtjes së stafit mjekësor me pajisje mbrojtëse personale kudo në sistemin publik, por edhe për zhvillimin e gjithanshëm të këtij sektori, për të tërhequr sa më shumë personel mjekësor në dhënien e kontributit për përballimin e situatës. Punësime shtesë janë bërë edhe në shërbimet epidemiologjike të strukturave shëndetësore në të gjithë vendin me qëllim forcimin e kapaciteteve të hetimit epidemiologjik dhe gjurmimit të rasteve gjatë pandemisë.

Gjithashtu, është punësuar personel shtesë shëndetësor për të siguruar rritjen e kapacitetit të burimeve njerëzore në spitalet Covid-19.

Në këtë drejtim, për të plotësuar nevojat e popullatës për kujdesin e duhur mjekësor, strukturat shëndetësore punuan për të siguruar:

- vazhdimësinë e kujdesit për të ofruar shërbime për popullatën;
- ngritjen e kapaciteteve në spitalet rajonale për diagnostikimin dhe trajtimin e diagnozave të ndryshme;
- sigurimin e kujdesit të koordinuar shëndetësor dhe mbështetjes sociale nga një ekip profesionistësh të kujdesit mjekësor dhe social.

Përtej kësaj, fushat kryesore shqetësuese të identifikuara si ndikuese në arritjen e synimeve për shëndetin dhe të lidhura me shëndetin përfshinë financimin e sektorit shëndetësor; organizimin e fragmentuar të kujdesit shëndetësor me përgjegjësi dhe autonomi të kufizuar; kapacitetet e ulëta dhe mbajtjen e profesionistëve të kujdesit shëndetësor; shpërndarjen e pabarabartë të burimeve njerëzore të sektorit shëndetësor në të gjithë vendin; cilësinë e ulët, integritimin dhe përdorimin e të dhënave për shëndetin dhe të lidhura me shëndetin së bashku

me mungesën e sistemit të vetëm të informacionit shëndetësor dhe mungesën e referencës sistematike për standardet e kujdesit dhe shërbimeve që mbështeten në evidenca.

Sigurimi i burimeve njerëzore të duhura për shëndetin është, gjithashtu, një përparësi e, për pasojë, duhet të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave të burimeve njerëzore për shëndetin, si dhe të tregohet një kujdes i veçantë për të vlerësuar planifikimin dhe prodhimin aktual të fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësor, në raport me nevojat e tregut aktual të punës në shëndetësi, duke identifikuar nevojat dhe opsionet kryesore për një strategji burimesh njerëzore në këtë sektor.

Për t'iu përgjigjur mungesave të burimeve njerëzore dhe sfidave për t'i mbajtur burimet ekzistuese në qendrat shëndetësore, duhet të eksplorohen opsionet për ngritjen e kapaciteteve, dhënien e stimujve të ndryshëm për studentët që ndjekin studimet në fushën e mjekësisë së përgjithshme, mekanizmat për të motivuar profesionistët e shëndetit për të vazhduar punën në Shqipëri dhe, sipas nevojave, edhe në zona rajonale e të largëta, me qëllim për të siguruar një shpërndarje më të mirë të burimeve njerëzore në fushën e shëndetësisë.

Efektet e pandemisë kanë lënë gjurmë në jetën e përditshme të miliarda njerëzve në mbarë botën, kanë sfiduar sistemet kombëtare shëndetësore, shkencën dhe teknologjinë, si dhe kanë ridimensionuar shërbimet dhe punësimet në këtë sektor, kështu që fokusi i këtij projektligji do të jetë që të përgatisë profesionistë që i shërbejnë sistemit shëndetësor shqiptar për të menaxhuar pasojat e Covid-19 në mënyrë sa më efikase që të jetë e mundur dhe për të zhvilluar këtë sektor edhe në të ardhmen.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe zgjerimi i fushës së praktikës së profesionistëve, për shembull infermierëve. Investimi në një numër të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar shëndetësorë mund të kontribuojë në reduktimin e mungesave të fuqisë punëtore dhe problemeve që lidhen me mbajtjen e tyre në vendin e punës.

Kryerja e një transformimi të suksesshëm të kujdesit shëndetësor dhe krijimi i politikave të reja në këtë fushë do të kërkonte kapacitete të rëndësishme analitike dhe planifikimi në mënyrë që të llogariten të gjitha nevojat e mundshme të burimeve njerëzore për të ardhmen, gjithashtu, do të ndihmonte për të siguruar që sistemi i transformuar i kujdesit shëndetësor të kishte fuqinë punëtore deri në detyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor të përqendruar tek individi.

Sipas të dhënave të OECD-së, deri në vitin 2017 rreth 770 mjekë shqiptarë punonin në vende të tjera brenda OECD-së. Kjo është shifra e dytë më e ulët në rajon pas Malit të Zi (46 mjekë). Shifrat më të larta i arrin Serbia me 2 486 mjekë, pasuar nga Maqedonia e Veriut me 1 726 dhe Bosnia dhe Hercegovina me 1 129 mjekë.

Ndërkaq, vlerësohet se deri në vitin 2022 totali i mjekëve të trajnuar në Shqipëri, por që punojnë në vendet e OECD-së, është mbi 1 200 mjekë, me mbizotërim largimin drejt Gjermanisë, SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Kanadasë dhe Italisë. Shkalla e emigrimit vlerësohet të jetë rreth 19.8% ose, e thënë ndryshe, për çdo 10 mjekë që trajnohen në Shqipëri, afërsisht 2 largohen jashtë vendit.

Sipas bazës së të dhënave të OECD-së, totali i mjekëve që punojnë në vendet e OECD-së, por të trajnuar në vendet e Ballkanit Perëndimor, vlerësohet afër 7 000 në vitin 2021, shifër e cila do të thotë 13% e mjekëve të disponueshëm në rajonin e Ballkanit.

Implementimi i disa programeve, masave dhe politikave kanë dhënë rezultatet e para, duke rritur ndjeshëm densitetin e mjekëve. Aktualisht, rreth 5 400 mjekë ofrojnë shërbim në sistemin shëndetësor, përkthyer në 1.93 mjekë për çdo 1 000 banorë. Si rezultat i politikave të ndjekura, vërehet një rritje e densitetit të mjekëve, krahasuar me vitin 2013 (ku regjistroheshin rreth 1.2 mjekë/1'000 banorë). Gjithsesi, mbetet ende punë për të rritur më tej dendësinë e mjekëve në vend dhe për ta çuar në nivelin e vendeve të rajonit (2.6 mjekë/ 1000 banorë), e më tej edhe në nivelin e vendeve të OECD-së (3.6 mjekë/ 1000 banorë). Në përpjekje për të arritur këtë, janë ndërmarrë e vijojnë të implementohen në vazhdimësi një sërë masash, ku, ndër më të rëndësishmet, mund të përmendim:

- Rritja historike e pagave të mjekëve;
- Akordimi i bonusit për mjekët që punojnë në spitale larg vendbanimit;
- Bonusi për mjekët e sistemit parësor që punojnë në qendra shëndetësore në zona të izoluar;
- Implementimi i portaleve mjekë dhe infermierë për Shqipërinë, të cilët kanë rritur transparencën dhe besueshmërinë të procesi i punësimit në bazë të meritokracisë;
- Investimi në përmirësimin e kushteve të punës dhe modernizimin e pajisjeve e të infrastrukturës spitalore për t'u mundësuar mjekëve eksperiencë profesionale të denja dhe të plota;
- Implementimi i ligjit të ri për autonominë spitalore krijon hapësira për stimulimin e karrierës profesionale të mjekëve, duke lejuar praktikën e dyfishtë mjekësore etj.

Gjithashtu, për t'iu përgjigjur nevojave të sistemit dhe për të kundërshtuar efektin e largimit të mjekëve jashtë vendit, ka nisur rritja graduale e kuotave të çelura

çdo vit për programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës, duke arritur në 500 brenda vitit 2024.

Kostoja mesatare e studimeve për të gjitha fakultetet, sipas përlllogaritjeve të përcjella nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, sipas programeve të studimit, është si më poshtë:

- Bachelor, 381 643 lekë/vit;
- Master i Shkencave, 552 280 lekë/vit;
- Master profesional, 562 132 lekë/vit.

Kjo kosto bazohet në kuotat e miratuara si dhe numrin faktik të personelit akademik dhe atij ndihmës.

Sipas standardeve ndërkombëtare të përlllogaritjes së koston, shpenzimet për investime përlllogariten në masën 15% të shpenzimeve të personelit dhe shpenzimet korrente në masën 10% të shpenzimeve të personelit. Nëse Universiteti i Mjekësisë Tiranë do të respektojë standardet sipas Kodit të Cilësisë, kostoja mesatare e studimeve në nivel universiteti përlllogaritet rreth 370 000 lekë/vit, referuar normativave të përcaktuara në Kodin e Cilësisë si dhe përlllogaritjet për shpenzime korrente dhe kapitale.

Sipas informacionit të përcjellë nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kostoja e studimit për programin e integruar të studimit në “Mjekësi e Përgjithshme” është 678 994 lekë në vit/student. Sidoqoftë, duke patur parasysh nevojën për transparencë lidhur me këtë element, në projektligj u parashikua detyrimi për përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes së koston me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pavarësisht të gjitha arritjeve falë implementimit të politikave të mësipërme, ka një nevojë imediate për të adresuar në mënyrë më shteruese dhe më konkrete fenomenin e largimit të mjekëve nga sistemi dhe nga vendi dhe boshllëqet e krijuara për pasojë.

Projeksionet dhe vlerësimet e situatës për të ardhmen janë bërë duke marrë parasysh një sërë faktorësh, si përqindjen e mjekëve të cilët dalin në pension çdo vit, peshën që zënë mjekët e moshës 55-65 vjeç, si dhe prurjet e reja që do të ketë sistemi prej licencimeve në sistemin publik dhe jopublik. Sa më sipër, nevojiten politika dhe programe afatmesme që të sigurojnë disponibilitetin e profesionistëve të shëndetësisë për të garantuar që fuqia e punës në shëndetësi t'i përgjigjet mbi të gjitha sigurisë së shëndetit të popullatës, bazuar në zhvillimet demografike dhe në përgjigje të fenomeneve si ai i mobilitetit të mjekëve në vende të tjera. Zbatimi i parashikimeve të këtij projektligji do të synojë zhvillimin

e vazhdueshëm të karrierës së studentëve të fushës së mjekësisë, duke e bërë sektorin e shëndetësisë sa më atraktiv dhe të konkurrueshëm me vendet e rajonit. Ky projektligj, duke ofruar trajtim të veçantë për kandidatët/studentët që regjistrohen për herë të parë apo ndjekin programin e integruar të studimit “Mjekësi e përgjithshme” dhe që pranojnë të punojnë në vend pas diplomimit të tyre, do të nxisë të gjithë studentët që të kontribuojnë në sistemin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë, si dhe u jep atyre një shtysë për ecurinë e tyre dhe përfshirjen në tregun e punës pas diplomimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me nenin 57 të Kushtetutës, ku përcaktohet e drejta për arsim, si një e drejtë universale kushtetuese.

Projektligji nuk e cenon thelbin e kësaj të drejte kushtetuese, duke qenë se çdo subjekt i zbatimit të saj ka të drejtën e zgjedhjes nëse dëshiron të përfitojë nga lehtësitë që krijohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë apo nëse nuk pranon për të lidhur këtë marrëveshje, duke i përgjigjur detyrimeve që lindin për pagesën e tarifave të studimit deri në nivelin e kostos së përlllogaritur për ndjekjen e këtyre studimeve.

Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet se:

*“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Me anë të këtij projektligji nuk cenohet thelbi i së drejtës për arsim, pasi çdo kandidat/student që regjistrohet apo ndjek studimet në programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mjekësisë i garantohet së pari e drejta për arsim me plotësimin e kriterëve ligjore për ndjekjen e këtij programi studimi dhe së dyti ai ka të drejtën e zgjedhjes nëse do të përfitojë apo jo nga lehtësitë/përfitimet që krijohen përmes këtij projektligji, nëpërmjet zgjedhjes së tij për të nënshkruar apo jo një marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik.

Efektet, që do të rrjedhin nga ky projektligj, i përkasin së ardhmes, ku theksojmë se kjo vlen edhe për studentët e ndërmjetëm, që aktualisht ndjekin këtë program studimi në institucionin e arsimit të lartë publik, për të cilët efektet e zbatimit të këtij projektligji vlejnë vetëm për vitet e mbetura për të kryer nga ana e tyre.

Ky propozim i përcjellë përmes këtij projektligji është mbështetës për kandidatët/studentët e mjekësisë, pasi me nënshkrimin e marrëveshjes së sipërcituar, ata mund të përfitojnë nga e drejta për të mos paguar detyrimet financiare që lidhen me pagimin e tarifës së studimeve përgjatë viteve që do të ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme”, si dhe nga lehtësi të tjera që jepen përmes këtij projektligji.

Duke konsideruar që interesi publik për të garantuar plotësimin e nevojave për burime njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë është mjaft i lartë edhe dispozitat që përcillen përmes këtij projektligji janë hartuar në përputhje me nevojat e diktuar në vend, duke përmbushur, në këtë mënyrë, në përputhje të plotë si me nenin 17 të Kushtetutës, ashtu edhe me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative ku parashikohet se:

*“1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:*

- a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;*
- b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe*
- c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.”*

Gjejmë rastin të përmendim se GJEDNJ-ja, në praktikën e saj pranon se për shkak të njohjes së saktë të shoqërive të tyre dhe nevojave që ato kanë, në parim autoritetet kombëtare mund të bëjnë vlerësimin fillestar lidhur me ekzistencën e një problemi që shqetëson publikun. I tillë është ofrimi i shërbimit shëndetësor, ku nevojitet ndërhyrja, duke garantuar marrjen e masave që do të zbatohen në fushën e ushtrimit të profesionit të mjekut, duke përfshirë detyrimin për të kontribuar në kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësojmë se, sipas parimit të sigurisë juridike, sipas përcaktimeve të këtij projektligji, respektohet vullneti i lirë i çdo kandidati apo studenti për të vendosur vetë nëse do të përfitojë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, me nënshkrimin

e marrëveshjes apo në të kundërt të përballojë tarifën e studimeve deri në nivelin e kostos së tyre.

Në këtë mënyrë, nuk kemi as cenim të së drejtës së fituar edhe nga studentët e ndërmjetëm, që ndjekin studimet në këtë program studimi, pasi tarifat e reja të përcaktuara, në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes, i referohen vetëm viteve të ardhshme akademike, pa pasur efekte prapavepruese. Kjo kategori studentësh do të përfshihet si pjesë e zbatimit të projektligjit me qëllim plotësimin sa parë të nevojave për mjekë me qëllim mbulimin me shërbim shëndetësor sa më cilësor për qytetarët kudo ato ndodhen. Referojmë se Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.1, datë 16.1.2017, në lidhje me parimin e sigurisë juridike ka arsyetuar në mënyrë të përgjithshme se *“parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.”* Nisur nga sa më sipër, edhe në rastin konkret, interesi publik në garantimin e shërbimit mjekësor për popullsinë mbizotëron ndaj pritshmërisë së subjekteve në fjalë (studentëve që janë në ndjekje e sipër të programit të studimit në mjekësi) për të vijuar edhe kohën e mbetur të studimit me të njëjtin trajtim dhe kushte që kanë pasur deri më tani. Kjo pritshmëri nuk mund të ketë prioritet ndaj interesit të përgjithshëm për sigurimin e shërbimit shëndetësor në tërësi.

Referuar nenit 17 të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës, kriteri i parë i kufizimeve, pra detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj në kuptimin formal, rezulton të jetë i respektuar, mjafton që ndërhyrja të jetë bërë nëpërmjet një ligji të miratuar nga Kuvendi, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim. Kriteri i dytë është ekzistenca e interesit publik. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll para saj. Gjykata ka theksuar, sikurse e përmendëm më sipër, në jurisprudencën e saj se si parimi i sigurisë juridike nuk është absolut dhe mund të kufizohet nëse për këtë ka një arsye legjitime ose një interes publik, mosrespektimi i të cilit do të sillte pasoja të rënda për rendin juridik ose social në vend. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, vlerësojmë se plotësohen të dyja kushtet që bëhen nëpërmjet ndërhyrjes legjislative sipas këtij ligji edhe interesi publik por edhe vendosja e detyrimeve me ligj.

Po ashtu, theksojmë se “punësim” do të konsiderohet edhe periudha e specializimit afatgjatë, pavarësisht llojit të kuotës së fituar, ku një pjesë e studentëve, përveç se kryejnë procesin e specializimit në strukturat shëndetësore përkatëse, duke kontribuar si në zhvillimin e tyre profesional, (edhe do të paguhen për rastin e studentëve që u përkasin kuotave të mbuluara në specializimet afatgjata në mjekësi, duke respektuar detyrimet sipas marrëveshjes përkatëse të nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë), ashtu edhe në përmbushjen e detyrimit si periudhë punësimi në Shqipëri.

Gjithashtu, zbatimi i përcaktimeve të këtij projektligji do të fillojë nga viti akademik 2023-2024 deri në vitin akademik 2027-2028 e, për pasojë, efekti i tij do të jetë i përkohshëm, që të investojmë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor kombëtar të fortë, rezistent, për të përmirësuar kapacitetet, duke ruajtur forcën e punës në shëndetësi dhe duke promovuar kujdesin social, njëlloj i rëndësishëm me atë shëndetësor.

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës. Është propozuar që projektligji të shqyrtohet dhe të miratohet me procedurë të përsheptuar, për shkak të nevojës emergjente që paraqitet për miratimin dhe hyrjen në fuqi të tij, para fillimit të procedurave për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve për studentë në fushën e mjekësisë për vitin e ri akademik 2023-2024. Në këtë aspekt, theksojmë se duke qenë se viti i ri akademik fillon në datën 2.10.2023 dhe aplikimet për të përzgjedhur programet e studimit fillojnë gjatë muajit korrik, vlerësojmë se është shumë e domosdoshme që ligji të ketë hyrë në fuqi para zhvillimit të procedurave për regjistrim nga studentët me qëllim që ata të njihen me përmbajtjen e tij dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për zbatim.

Në lidhje me procedurën e përsheptuar sqarojmë se ky projektligj nuk përfshihet në listën e projekteve, për të cilat nuk lejohet procedura e përsheptuar për shqyrtimin dhe miratimin e tyre, siç përcaktohet në nenin 81, pika 3, ku parashikohet se:

“Procedura e përsheptuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit “dh””.

Pika 2 e nenit 81, të Kushtetutës, përcakton se:

“2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

- a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;*
- b) ligji për shtetësinë;*

- c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore;
- ç) ligji për referendumet;
- d) kodet;
- dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;
- e) ligji për statusin e funksionarëve publikë;
- ë) ligji për amnistinë;
- f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.”.

Në kushtet kur ky projektligj nuk përfshihet në asnjë prej projektakteve që përjashtohen nga zhvillimi i procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e tyre, sugjerojmë shqyrtimin e tij në Kuvend me këtë procedurë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është i strukturuar në 11 nene.

Neni 1 parashikon objektin e këtij ligji i cili përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 2 parashikon qëllimin, sigurimin e burimeve njerëzore për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë.

Neni 3 parashikon përkufizimet se çfarë konsiderohet trajtimi i veçantë, i cili përfshin punësimin prioritar të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përfitimi nga programet sociale të strehimit, si dhe çfarë konsiderohet “punësim me prioritet”, sipas të cilit me këtë përcaktim kuptohet nisma për t’i dhënë përparësi punësimit në institucionet e shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë të studentëve që diplomohen në këtë program studimi dhe kanë nënshkruar marrëveshjen, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 4 parashikon kategoritë përfituese të trajtimit të veçantë të cilat janë, si më poshtë:

1. Trajtim të veçantë përfiton kandidati që pranohet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë, kur plotëson kushtet, si më poshtë:
 - a) Plotëson deklaratën për përmbushjen e kushteve, parashikuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, përpara zhvillimit të testimit të detyruar për pranimin në këtë program studimi.
 - b) Nënshkruan marrëveshje, para regjistrimit të tij si fitues në këtë program, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik, për të punuar në profesionin e mjekut, pas përfundimit të studimeve, për jo më pak se 5 (pesë) vite në institucionet shëndetësore Republikën e Shqipërisë.
 - c) Pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 5 (pesë)-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare.
2. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik, kur pranon përmbushjen e kushteve, si më poshtë:
 - a) Nënshkruan marrëveshje, para fillimit vitit akademik përkatës dhe për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve, për jo më pak se 3 (tre) vite në institucionet shëndetësore Republikën e Shqipërisë.
 - b) Pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 3 (tre)-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare.
3. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të pestë ose të gjashtë në këtë program, kur pranon përmbushjen e kushteve, si më poshtë:
 - a) Nënshkruan marrëveshje, para fillimit vitit akademik përkatës dhe për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë

dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve, për jo më pak se 2 (dy) vite në institucionet shëndetësore Republikën e Shqipërisë.

- b) Pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 2 (dy)-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare.

Neni 5 parashikon detyrimet për studentët që nuk nënshkruajnë marrëveshje për pagesën e vlerës së plotë të kostos së studimeve. Studenti, që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshje për të punuar në një institucion shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, publik ose privat, nga data e lindjes të së drejtës për punësim, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik, sipas përcaktimeve të nenit 4 të këtij ligji, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve, metodologjia e llogaritjes së të cilës, së bashku me çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6 parashikon të drejtën e punësimit me prioritet në institucionet shëndetësore për studentin që përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nga momenti i lindjes të së drejtës për punësim.

Mënyra dhe procedura e punësimit me prioritet përcaktohet më udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Në rast mospunësimi të tij brenda 1 (një) viti kalendarik nga data e lindjes të së drejtës për punësim, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohet i përmbushur detyrimi sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ka të drejtën të pajiset me diplomën përkatëse universitare.

Neni 7 parashikon të drejtën për përfitime nga trajtimi i veçantë. Kandidati/studenti, që ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, ka përparësi në përfshirjen në programet sociale të strehimit.

Masa e subvencionimit të interesave të kredisë për strehim llogaritet si diferencë midis interesit të dakordësuar me institucionet financiare dhe interesit që paguan kandidati/studenti, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Neni 8 trajton periudhën e studimeve në specializimet afatgjata në mjekësi e, konkretisht: “Në rast të ndjekjes së studimeve në specializimet afatgjata në mjekësi në institucionet publike të arsimit të lartë, periudha e ndjekjes së këtyre

studimeve konsiderohet si periudhë punësimi, në rast se studentët përfshihen në kuotat e pambuluara. Studentët e kuotave të mbuluara në specializimet afatgjata në mjekësi respektojnë detyrimet, sipas marrëveshjes përkatëse të nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, dhe periudha e punësimit në Shqipëri konsiderohet detyrim i përmbushur.

Neni 9 parashikon dispozitat kalimtare, ku përcaktohet se ky ligj zbatohet nga viti akademik 2023-2024 deri në vitin akademik 2027-2028.

Neni 10 parashikon dispozitat mbi detyrimin për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij projektligji.

Neni 11 parashikon hyrjen në fuqi të tij, duke përcaktuar se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar dhe koordinuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, me kontributin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet publike të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në fushën e mjekësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOR

Miratimi i këtij projektligji mund të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit/Universitetin e Mjekësisë Tiranë, vetëm në rast se të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi nuk pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen për mbajtjen e diplomës për një periudhë 2 (dy)-vjeçare deri 5 (pesë)-vjeçare pas përfundimit të studimeve.

Sipas një skenari optimist, nëse të gjithë studentët pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe të punojnë në Republikën e Shqipërisë, efekti financiar shtesë, që duhet të përballohet nga buxheti i shtetit apo universiteti, përlllogaritet rreth 38 835 000 lekë të ardhura të munguara për shkak të përjashtimit të të gjithë

studentëve nga tarifat e shkollimit dhe do të nevojiten fonde shtesë për të përballuar këtë efekt financiar nga buxheti i shtetit.

Aktualisht, janë 863 studentë, të cilët përfitojnë përjashtimin nga tarifa e studimit, me efekt financiar 38 835 000 lekë.

Sipas një skenari më realist, supozohet se 50% e studentëve do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe në këtë skenar, efekti financiar përlllogaritet sa më poshtë:

- Efekti financiar për studentët që do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshjen (përveç atyre që tashmë e përfitojnë përjashtimin) për shkak se do të nënshkruajnë marrëveshjen për qëndrim 2-5 vjeçar në Shqipëri përlllogaritet: $325 \text{ studentë shtesë} \times 45.000/2 \text{ lekë} = 7.312.500 \text{ lekë fonde të nevojshme nga buxheti i shtetit për përballimin e përjashtimit nga tarifa. Kjo kategori studentësh supozohet se do të paguajë 50\% të tarifës (45.000/2 lekë).}$
- Fondet nga arkëtimi i tarifave të studimit për pjesën e studentëve, që nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje, do të vlerësohen pas përcaktimit të metodologjisë përkatëse, e cila do të realizohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij projektligji. Në një vlerësim optimal, tarifat aktuale të studimit në programin e studimit “Mjekësi e përgjithshme” vlerësohen në intervalin 6%-8% të kostos së plotë të studimeve. Pas miratimit të këtij projektligji, institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë koston reale të studimit, e cila do të realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar. Elementet kyç, mbi të cilat do të bazohet metodologjia e përlllogaritjes së kostos, janë shpenzimet e personelit, të cilat në institucionet e arsimit të lartë publike vlerësohen rreth 75% të kostos së studimit, shpenzimet korrente për blerje mallrash dhe shërbimesh të cilat vlerësohen rreth 10% të kostos dhe shpenzimet kapitale të cilat zënë rreth 15% të kostos së studimit.

Sipas një skenari pesimist, në rast se të gjithë studentët nuk do të pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje dhe do të paguajnë koston e plotë të studimeve, efekti financiar në të ardhura (bazuar në koston e përafërt të studimit) përlllogaritet rreth 1,6 miliardë lekë shtesë, por sipas këtij skenari, asnjë student nuk do të pranojë të nënshkruajë marrëveshje për qëndrim 2-5-vjeçar në Shqipëri, që në vlerësimin tonë është një skenar jorealit.

KËSHILLI I MINISTRAVE